



Projekti: Bjeshka e Moknës – Perla e pazbuluar e shtegut Via Dinarica

Për shtyp:

Një interesim i lartë në zhvillimin e turizmit aktiv në bjeshkën e Moknës

Takimi i parë i forumit për zhvillimin e turizmit aktiv në këtë bjeshkë, e njohur edhe si “Bukuroshja e Ballkanit”, u organizua në korniza të projektit “Bjeshka e Moknës – Perla e pazbuluar e shtegut Via Dinarica”. Forumi u mbajt me 30 janar 2019, në Tutin, i cili mbledhi rreth 90 përfaqësues të komunave, organizatave turistike, afaristë, shoqata bjeshkatarësh dhe sportistësh si dhe organizata joqeveritare. Kjo është hera e parë që pjesëmarrësit nga komunat përfaqësojnë bjeshkës së Moknës, pjesëmarrës nga Rozhaja, Tutini, Peja, Istogu dhe Zubin Potoku, u takuan.

Forumit u hap nga Kenan Hot, kryetar i komunës së Tutinit, i cili i mirëpriti pjesëmarrësit në Tutin dhe shprehi kënaqësinë për nisjen e iniciativës për bashkëpunim të përbashkët në mes të komunave që rrethojnë bjeshkën e Moknës. Kryetari Hot tha se ky projekt do të ketë një karakter të veçantë ekonomik, do të lansojë zhvillimin e turizmit dhe bashkëpunimin sa i përket organizimit të evenimenteve sportive dhe kulturore, si dhe jetën e gjithëmbarshme shoqërore në këtë rajon. Ai poashtu falemnderoi Bashkësinë Evropiane dhe Këshillin për Bashkëpunim Rajonal për mbështetjen e dhënë kësaj iniciative e cila do të ndihmon në promovimin e Moknës si një destinacion turistik më i bukuri në Ballkan.

Dragisha Mijaçiq, drejtor i Institutit për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER), tha se pa një nxitje sociale për bashkëpunim multi-sektoral dhe pa projekte afatgjata, nuk ka zhvillim socio-ekonomik. Mijaçiq i ftoi të gjithë pjesëmarrësit e forumit që të marrin pjesë me përkushtim në realizimin e projektit, gjë që përfaqëson aktivitetin fillestar për zhvillimin e turizmit në këtë bjeshkë, e cila, me bukurinë e saj të natyrës, objektet tërheqëse për turistët dhe ambienti multi-kulturorë, mund të tërheqë vëmendje të ndjeshme për turistët nga e gjithë bota.

Edhe Liljana Ceroviq, përfaqësuese e Organizatës Turistike të Serbisë, iu adresua pjesëmarrësve e cila e mirëpriti karakterin rajonal të këtij projekti dhe theksoi se kjo do të promovon një destinim të ri për turistët. Znj. Cerovic theksoi se Serbia ka shënuar rritje dyshifrore të turistëve në vite me rradhë dhe se është vënë në pah kërkesa për aktivitete të pushimeve aktive. Prandaj Organizata Turistike e Serbisë do të jetë e vullnetit që të mbështes këtë projekt dhe të promovon destinacionin turistik të bjeshkës së Moknës në panairët ndërkombëtarë dhe vendore, në media dhe në rrjetet sociale.



Provided by the RCC Tourism
Development and Promotion
Project's Grant Programme



The Project is funded
by the European Union



Pas prezantimeve për pjesëmarrësit në forum, u prezantuan objektivat dhe aktivitetet e projektit bashkë me rezultatet konkrete të arritura nga kjo iniciative për zhvillim. Tutje, pjesëmarrësit u ndanë në grupe ku diskutuan format e ndryshme të veçanta për bashkëpunim përbrenda kornizave të projektit.

Interesimi më i madh i pjesëmarrësve u shfaq në aktivitetin e përcaktimit të shtegut për ecje nga Gryka e Rugovës, përmes Hajlës, Ahmicës, përgjatë bjeshkës së Moknës, Pogledit e deri në Berim. Në bjeshkën e Moknës, shtegu do të jetë në formë qarkoreje në mënyrë që njëra pjesë do të kalon nga ana e komunës së Tutinit ndërsa pjesa tjetër përmes komunës së Istogut. Shtegu do të bëhet sipas standardeve të Via Dinarica dhe do të përshkon përskaj vendeve më atraktive të natyrës, produkteve turistike dhe objekteve për akomodim.

Forumi ishte organizuar si një aktivitet përbrenda kornizës së donacionit të projektit "Promovimi dhe Zhvillimi i Turizmit" i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Projekti është fondacion i Bashkësisë Evropiane dhe i zbatuar nga KBR në mënyrë që të jap kontribut në rritjen dhe garimin në mes të ekonomisë së gjashtë vendeve të Ballkanit duke mbështetur zhvillimin dhe promovimin e ofertës së përbashkët në lëmin e kulturës rajonale dhe turizmit avanturesk.

Projekti "Bjeshka e Moknës – Perla e pazbuluar e shtegut Via Dinarica" zbatohet nga InTER, në bashkëpunim me komunën e Tutinit, Agjensionit Rajonal për Zhvillim SEDA nga Novi Pazari, OJQ "Marimangat e Pejës" dhe Shoqatën Bjeshkatare "Ahmica" nga Rozhaja. Projekti ka filluar në fillim të nëntorit 2018 dhe do të zgjas deri në qershor të vitit 2019 (7 muaj). Për më shumë informata mund të lexoni në veb faqen www.regionalnirazvoj.org

Për më shumë informata:

Dragisa Mijacic, Drejtor i InTER

Tel.: +381(0)638550929

E-mail: dmijacic@regionalnirazvoj.org



Provided by the RCC Tourism
Development and Promotion
Project's Grant Programme



The Project is funded
by the European Union